

VENDIM
Nr.667, datë 21.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA VRESHTAS TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Vreshtas të qarkut të Korçës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 7 (shtatë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Vreshtas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni pushtetit qendror: MMPAU Bashkia: Vreshtas										
Nr. rend.	Numri i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore EPK Shtrirja gjeografike e EPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësitë administrative	Institucioni, enti përdoues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	241	liqenas	korite	136	Pyll	38.5	prodhues	D.Sh.P.Korce	D.Sh.P.Korce	
2	242		korite	137	Pyll	34.5	prodhues	D.Sh.P.Korce	D.Sh.P.Korce	
3	243		korite	138	Pyll	39.25	prodhues	D.Sh.P.Korce	D.Sh.P.Korce	
4	244		korite	139	Pyll	32.25	prodhues	D.Sh.P.Korce	D.Sh.P.Korce	
5	245		korite	140	Pyll	57.25	prodhues	D.Sh.P.Korce	D.Sh.P.Korce	
6	246		çezma e baxhos	141	Pyll	38.75	prodhues	D.Sh.P.Korce	D.Sh.P.Korce	
7	247		çezma e baxhos	142	Pyll	31	prodhues	D.Sh.P.Korce	D.Sh.P.Korce	

Njësia e qeverisjes vendore: bashkia Vreshtas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
241-247	Pyje	Në pronësi